

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCIME

Gjatë muajit shkurt, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat e licencimit për subjektet e mëposhtme:

Shoqëria "ATEANI ENERGY" shpk, në veprimtarinë e prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike;

Shoqëria "ENERGY MARKET ALBANIA" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;

Shoqëria "KURUM INTERNATIONAL" sha, për modifikimin e licencës miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike;

Shoqëria "NATYRE ENERGY" shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;

Shoqëria "SUN ENERGY SOLUTIONS" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet 2MW.

BASHKËPUNIME

NË DATËN 10 SHKURT 2023, ME FTESË TË KRYEMINISTRISË, U ZHVILLUA NJË TAKIM I PËRBASHKËT ME QËLLIM PREZANTIMIN E DRAFTIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT DHE INTEGRIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË. TË FTUAR ISHIN AKTORËT ME RËNDËSI NË RRUGËTIMIN E ZHVILLIMIT TË VENDIT, NDËR TË CILËT DHE Z. PETRIT AHMETI, KRYETAR I ERE.

GJATË KËTIJ TAKIMI, U PREZANTUAN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR, NGA DREJTUES TË SECILËS MINISTRIE, VIZIONI DHE SHTYLLAT KRYESORE MBI TË CILAT DO TË MBËSHTETET KJO STRATEGJI, NDËR TË CILAT INTEGRIMIN NË BE, LUFTA ANTIKORRUPSION, ENERGJIA, AGRIKULTURA, TURIZMI DHE DIXHITALIZIMI I VENDIT. PËR TË GJITHA KËTO, KRYEMINISTRI U SHPREH MBI SFIDAT E IMPLEMENTIMIT TË KËSAJ STRATEGJIE, DUKE I LËNË MË PAS FJALËN Z. BEQAJ SI DREJTUES I AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS (SASPAC) PËR TË FOLUR MBI MONITORIMIN E TREGUESVE NË VAZHDIMËSI SI DHE PËR TË BËRË NJË PASQYRË TË EKONOMISË SHQIPTARE, TRANSFORMIMIT DHE SFIDAVE GJATË 10 VITEVE TË FUNDIT.

PARTNERË TË HUAJ SI DELEGACIONI I BE, PËRFAQËSUES TË SHBA, AUSTRIA, JAPONIA, MB, TURQIA, ISRAELI; PËRFAQËSUES TË OKB, BERZH, BANKËS BOTËRORE, BANKËS EVROPIANE PËR INVESTIME SI DHE FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR ETJ., TË GJITHË PREZANTUAN

PROGRAMET E TYRE TË ZHVILLIMIT NË SHQIPËRI. DISKUTIMET MBI ÇËSHTJE TË TEMATIKËS POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE, U PASUAN NGA FJALIMI PËRMBYLLËS I KRYEMINISTRIT RAMA.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TEC

Në datat 31 janar dhe 1 shkurt 2023, Kryetari i ERE-s së bashku me Bordin e Komisionerëve dhe Sekretarin e Përgjithshëm, kanë qënë të ftuar nga CRE – Komisioni Rregullator për Energjinë i Francës, në një takim dypalësh me qëllim njohjen e misionit të CRE.



Vizita e delegacionit të EREs u krye në vijim të takimit të zhvilluar nga ana e Rregullatorit Francez në Tiranë në vitin 2021 në kuadër të projektit të financuar nga ana e Agjencisë Franceze për Zhvillim, pjesë e reformës së sektorit energjistik.

LEXO MË SHUMË

Gjatë po këtij muaji, Bordi i ERE-s ka zhvilluar pesë mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 47 vendimmarrje. Këto të fundit kanë rezultuar në licencimin e një subjekti në tregtimin e energjisë elektrike si dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2023 prej 32.27 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit.

Gjithashtu, pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Për tu azhornuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare.

VENDIME

Gjatë muajit shkurt është rifreskuar seti i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Procedura e Tregtimit si dh e Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes.

[KLIKO KËTU](#)

Gjatë muajit shkurt gjithashtu u miratua çmimi i aplikueshëm i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues mepërparësi, në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 67, date 08.02.2023. Efektet financiare të çmimit të miratuar prej 10 Lekë/kWh fillojnë nga data 09.02.2023. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi i bordit të ERE-s nr. 327, date 14.12.2022 "Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023",shfuqizohet.